

Enver Hoxha

"për një Shqipëri më të mirë"

"për bashkimin e vërtetë të kombit"

"për mbarëvajtjen e atdheut"



ENVER HOXHA KOMISAR E KOMANDANT I UNÇSH SHKËLQEU SI STRATEG I MADH USHTARAK NË LUFTËN E DYTË BOTËRORE

Lufta e Dytë Botërore është ndeshja më e madhe ushtarake nga mbi 14'500 luftra që janë zhvilluar që nga kohët e lashtë e deri më sot. Ajo u zhvillua gjatë viteve 1939 – 1945 me pjesëmarrjen e 61 shteteve e vendeve të botës. Morën pjesë në luftë 110 milion ushtarë e civilë nga të pesë kontinentet të botës me shtrirjen e 41 shteteve. Konflikti botëror u zhvillua në tre kontinente: Evropë, Azi e Afrikë, por politikisht, moralisht e materialisht u përfshi edhe kontinenti i Amerikës.

Për të përballuar rrezikun e madh që i kanosej botës nga nazifashizmi i përbërë nga aleanca Gjermani – Itali – Japoni, që quhej boshti Romë – Berlin – Tokio, u krijua aleanca e madhe: BRSS – SHBA – Angli. PKSH dhe shoku Enver Hoxha e bënë Shqipërinë pjesë të kësaj aleance, ku Shqipëria aderoi në koalicionin e madh antifashiste në dhjetor 1942. Kështu Shqipëria për herë të parë u përfshi në një front botëror luftë të drejtë në krahun e fitimtarëve të mëdhenj. Kjo luftë e popullit shqiptar u konceptua nga PKSH dhe Enver Hoxha si vazhdim i drejtpërdrejtë i luftrave për liri e pavarësi.

Populli shqiptar dha një kontribut të madh në raport me popullsinë dhe sipërfaqen e territorit në Luftën e Dytë Botërore për fitoren mbi nazifashizmin, duke i shkaktuar atij rreth 70 mijë ushtarë e oficerë të vrarë, plagosur e zënë rob (26'594 të vrarë, 21'245 të plagosur, 20'800 të zënë rob), i shkatërroi dhe i zuri armikut 2'100 tanke, autoblinde dhe automjete, i zuri 4'000 topa dhe mortaja i rrëzoi 5 aeroplanë, i dogji 216 dopo etj. Ndërsa Shqipëria pësoi dëme të pallogaritshme duke u djegur e shkatërruar. Ranë dëshmorë 28'000 luftëtarë partizanë, u plagosën rreth 20'000 partizanë, u dogjën 21% e shtëpive (ose 63'000 shtëpi), 1/3 e gjësë së gjallë u asgjësuan e rrëmbyen, u internuan 15'000 vetë, dhjetra mijë vetë u burgosën e internuan në kampet e përqendrimit në vendet e tjera të pushturara nga Gjermania, ku shumë prej tyre u masakruan. Të gjithë minierat, fabrikat, portet, urat u shkatërruan. Humbjet në ekonomi llogariten në 2 miliard dollarë me kursin e atëhershëm.

Në Shqipëri shkelën 700 mijë forca italo-gjermane. Shqipëria u rezistoi ushtrive moderne dhe me përvojë lufte, ku u angazhuan 15 divizione me rreth 170 mijë trupa (100 mijë italianë dhe 70 mijë gjermanë); ndërsa UNÇSH pas 10 Korrikut 1943 kishte rreth 70 mijë trupa të inkuadruar në 24 brigada sulmuese, 8 divizione sulmues, 3 korparmata.

I rreshtova këto fakte historike jo se nuk dihen, por për të argumentuar të kundërtën e nihilistëve, fallsifikatorëve të historisë, ballisto-zogistëve, pseudonacionalistëve, reaksionarëve të djeshëm e të sotëm, pushtetarëve të djathtë apo të majtë që qeverisin fatkeqësisht këto 18 vjet Shqipërine, se LANÇ e organizuar dhe udhëhequr

nga PKSH dhe Komandanti i Përgjithshëm shoku Enver Hoxha, është dhe do të mbetet epepeja më e lavdishme e popullit tonë gjatë historisë së tij për çlirim kombëtar e shoqëror, është dhe do të mbetet lufta më heroike çlirimtare antifashiste që u shndërrua në revolucion popullor nëpërmjet kryengritjes së armatorsur, është e do të mbetet pjesë përbërëse i luftës botërore antifashiste, burim i përhershëm frymëzimi, krenarie dhe edukimi atdhetar brez pas brezi. Ky kontribut i popullit shqiptar dhe UNÇSH i është njohur dhe i njihet edhe sot e kësaj dite nga ish aleatët e Luftës së Dytë Botërore dhe është pasqyruar gjerësisht në burimet historiografike të vendit e të huaja si angleze, sovjetike, amerikane, gjermane, italiane, franceze etj.

Së dyti, se UNÇSH ka patur një komandant të lavdishëm që njihet botërisht me emrin Enver Hoxha.

Së treti, për të kujtuar se LANÇ nuk ishte luftë civile mes komunistëve dhe antikomunistëve shqiptarë, por një luftë për jetë a vdekje e popullit shqiptar, UNÇSH kundër okupatorëve dhe tradhëtarëve të vendit të cilët i përfaqësonin ju sot.

Së katërti, për t'iu kujtuar e argumentuar se shoku Enver Hoxha nuk erdhi nga rruga apo e morën nga rruga në PKSH, por që ai me shokë që e themeloi PKSH më 8 Nëntor 1941, se Enver Hoxha nuk erdhi rastësisht e spontanisht në politikën shqiptare, por që në moshë fare të re gradualisht u edukua e u kalit si revolucionar, patriot i flaktë, e markist-leninist i shquar, duke arritur të themelojë PKSH, të organizojë popullin në luftë kundër pushtuesve e tradhëtarëve të vendit dhe të sigurojë fitoren e madhe më 29 Nëntor 1944, çlirimin e vendit dhe vendojen e pushtetit popullor.

Në këtë shkrim do të flas si e nisi jetën si revolucionar shoku Enver Hoxha dhe arriti të bëhet komisar, komandant i UNÇSH, një udhëheqës popullor, strateg ushtarak i njohur brenda e jashtë vendit.

Enver Hoxha që në moshë të re rreth 12 vjeç i bënin përshtypje vullnetarët gjirokastritë që shkonin në Luftën e Vlorës në vitin 1920 dhe i lanë gjurmë e krijuan te ai ndjenja revolucionare atdhetare. Ai admironte Avni Rustemin dhe simpatizonte shoqërinë përparimtare „Bashkimi“ të revolucionit demokratiko-borgjez të qershorit 1924. Pas ardhjes në fuqi të Ahmet Zogut në dhjetor, në moshën 16 vjeçare do të rresthohej më forcat kundërstare të regjimit obskurantist e mesjetar që sundonte në Shqipëri. Të gjitha ngjarjet e lëvizjet demokratike të viteve 1920 – 1924 i lanë mbresa të pashlyeshme në jetën e tij. Enver Hoxha ishte ndër inisiatorët dhe sekretar i shoqërisë „Studenti“ të Gjirokastrës që u krijua në korrik 1924, shoqëri i cila me veprimtaritë e saj kulturore-artistike ngjallte dashurinë për Atdheun, për lirinë e demokracinë. Ai kur ishte student në universitetin e qytetit Monpelje të Francës, ku studionte për shkencat e natyrës, mori pjesë në mitingjet e organizuara nga PK e Francës. Për këtë aktivitet me karakter revolucionar, në vitin 1933 qeveria e Zogut i preu bursën, ku iku në Paris me shpresë për të gjetur punë e vazhduar studimet në fakultetin e drejtësisë, por nuk gjeti dhe shkoi në Belgjikë, ku mundi të punësohet nëpunës në konsullatën shqiptare në Bruksel dhe regjistrohet në fakultetin e drejtësisë të universitetit të lirë të Belgjikës. Këtu ai fillon të shkruajë artikuj për gazetën „L'humanité“ – organ i PKF. Kështu në vitin 1936 regjimi i Zogut e pushoi nga puna me motivacionin se e kishte kthyer konsullatën në arsenal të literaturës

marksiste. Kështu Enver Hoxha në vitin 1936 u kthye përfundimisht në Shqipëri, tashmë i brumosur me idetë morale të shëndosha dhe me bindje politike të botëkuptimit revolucionar përparimtar. Dy muaj pas kthimit të tij në Shqipëri mori pjesë në misionin e lartë atdhetar për gjetjen në fushën e Shtojit në Shkodër të eshtrave të kapitanti të madh shqiptar Çeriçiz Topulli e të publicistit Muço Qulli, ku mbajti një fjalim para popullit të Shkodrës, ku shprehu nderim për patriotët e lëvizjes kombëtare. Në prill 1937 emërohet mësues në Liceun e Korçës, ku hyri në lidhje me grupin komunist të Korçës. Ngjarjet e 7 prillit 1939 e gjetën Enver Hoxhën në Korçë në krye të përpjekjeve për organizimin e një fronti të përbashkët antifashist. Për këtë e veprime të tjera ai u pushua nga puna me motivacionin: "Është kundër regjimit, s'ka pranuar të shkruhet fashist". Vëtëm 20 ditë pas krijimit të PKSH (8 nëntor 1941) shoku Enver Hoxha organizoi dhe drejtoi demonstratën e 28 nëntorit 1941 të përbërë nga qindra e mijëra demonstrues në sheshin „Skënderbej“ të sotëm. Ky ishte një aksion i madh politik i përbashkët i grupeve komuniste tashmë të bashkuar në PKSH. Në këtë demonstratë Enver Hoxha u ndesh fizikisht me oficerin që komandonte karabinierët duke e shtrirë përtokë atë me grushtin e fuqishëm të tij. Për këtë në mëngjesin e 29 nëntorit 1941, karabinierët shkojnë për ta arrestuar në dyqanin „Flora“ ku punonte, por fatmirësisht nuk e njihnin fizikisht. Në këtë kohë Enver Hoxha thirri një nga karabinierët „Dove Enver Hoxha“ dhe pas një pauze të shkurtër i thotë qetësisht: "Ja këtu është, prisni një minutë ju lutem ta lajmëroj". Karabinierët u bindën. Ai pasi hyri në lokal thirri me zë të lartë: "Enver të kërkojnë" dhe nga dera e pasme e lokalit doli dhe iku pa u vënë re. Nga ky moment e deri në prag të çlirimit qëndroi në ilegalitet. Ja kështu erdhi Enver Hoxha në skenën politike shqiptare. Në kohën kur Shqipëria ndodhej në udhëkryq të historisë dhe mbretmadhnia Ahmet Zogolli e la Shqipërinë e shitur prej tij tek Italia dhe ia mbathi nëpër botë duke marrë floririn e shqiptarëve. Enver Hoxha në kushtet e terrorit më të egër dhe i dënuar me vdekje në mungesë nga gjyqet e fashizmit, duke sakrifikuar gjithçka dhe vënë në rrezik jetën u vu menjëherë në ballë të punës e përpjekjeve për organizimin e LANÇ dhe të organave të saj udhëheqëse si Frontin ANÇ, të pushtetit të këshillave nacionalçlirimtarë, të UNÇSH dhe të Shtabit të Përgjithshëm.

Enver Hoxha nuk ka mbaruar shkolla ushtarake. Këtë përgjigje e jep vetë kur e pyet gjenerali Deivis – shef i misionit anglez pranë Shtabit të Përgjithshëm në kohën kur Shtabi i Përgjithshëm ishte i rrethuar nga gjermanët. Deivisi pyet Enver Hoxhën: "Keni bërë ndonjë shkollë ushtarake?" Ai i përgjigjet: "Po, kam bërë shkollën luftarake të popullit tim, e cila është një shkollë me eksperiencë të madhe. Gjergj Kastrioti – Skënderbeu u bë i njohur në të gjithë botën se luftoi kundër osmanllinjve, kundër dy sulltanëve nga më të mëdhenjtë, 22 beteja udhëhoqi, asnjë nuk humbi. Sulltan Mehmet Fatiu e mposhti Bizantin, por Krujën sa qe gjallë Skënderbeu nuk e mori dot".

PKSH dhe Enver Hoxha duke u mbështetur në mësimet e M-L për ushtrinë dhe mbrojtjen dhe në përshtatje me kushtet konkrete të vendit tonë kanë përpunuar dhe vijën ushtarake të Partisë, si pjesë e pandarë e vijës së përgjithshme të saj. Kështu që në mbledhjen themeluese të PKSH vihej detyrë: "Të përgatitej politikisht e ushtarakisht populli drejt kryengritjes së përgjithshme me armë duke përmbledhur në luftë të gjitha fuqitë patriotike dhe antifashiste".

Për sigurimin e fitores mbi armiqtë PKSH zgjidhi tre detyra kryesore:

1. Bashkimin e masave të gjera të popullit në Frontin Nacionalçlirimtar.
2. Organizimin e kryengritjes së përgjithshme, armatosjen e popullit, krijimin e ushtrisë së rregullt nacional-çlirimtare.
3. Shkatërrimin e pushtetit të pushtuesve dhe çifligarëve e të borgjezisë, organizimin dhe vendosjen e demokracisë popullore.

Për të forcuar këto themele dhe për të vënë bashkimin e popullit mbi baza të shëndosha politike dhe organizative në shkallë kombëtare PKSH organizoi Konferencën e Pezës më 16 shtator 1942 në Pezë, ku kjo konferencë pranoi platformën e LANÇ që qe përpunuar nga PKSH dhe shoku Enver Hoxha. Në këtë konferencë u afirmua roli udhëheqës i PKSH, u hodhën themelet e pushtetit popullor, u krijua Fronti Nacionalçlirimtar duke shënuar kështu fitoren e parë të madhe.

PKSH dhe shoku Enver Hoxha pas Konferencës së Pezës e përqendruan punën në organizimin e UNÇSH në luftë me pikëpamjet disfatiste armiqësore të propaganduar nga ballistët që trumbetonin në të gjitha anët së shqiptarët nuk mund të luftonin dot, ata nuk duhet të luftonin kundër Italisë, pasi atë do ta shkatërronin aleatët. Në përgjigje të këtyre zotërinjve Enver Hoxha në gazetën „Zëri i Popullit“ shkruante: „Ç’ngjet po të arsyetonin gjithë bota si këta „politikanë të mëdhenj“... ngjet një gjë shumë e thjeshtë që... Shqipëria e vogël... bëhet për jetë raja e Musolinit“.

Dihet se PKSH dhe Enver Hoxha nuk trashëguan asgjë nga e kaluara që të organizonin UNÇ. Ata e krijuan e organizuan ushtrinë e re pa patur asgjë të gatshme dhe pa ndihmën e jashtme, kur dihet se historikisht ushtritë e rregullta kanë lindur nga një bazë e trashëguar, ku udhëheqësve ushtarakë u është dashur vetëm të bëjnë përshtatje e përmirësime të organizimit egzistues, përvojën dhe taktikën.

PKSH dhe Enver Hoxha u nisën organizimin e ushtrisë nga njësitet guerile dhe brenda një kohe të shkurtër arritën të krijojnë një ushtri vullnetare të armatosur, një ushtri politike të udhëhequr nga PKSH të dalë nga gjiri i popullit dhe të lidhur ngushtë me të. Kjo është një nga veprat monumentale të shokut Enver Hoxha. Ai në krye të PKSH në përpjekje të ashpra me armiqtë e jashtëm e të brendshëm, me oportunistë e fraksionistë, hartoi dhe përpunoi vijën e përgjithshme politike të ushtrisë dhe gjeti e përcaktoi rrugët kryesore për të arritur në fitorën e 29 nëntorit 1944.

Rezistenca antifashiste që kishte filluar më 7 prill 1939 kundër fashistëve italianë vazhdoi ngjitjen në organizimin e njësiteve guerile e çetave partizane, të cilat e bënë bërthama e krijimit të ushtrisë së ardhshme. Ajo që bëri jehonë të madhe në atë kohë ishte krijimi i të parë çetë partizane antifashiste në Evropë në qershor të vitit 1940 në Pezë nga Myslim Peza. Pas çetave partizane u krijuan batalionet partizane në çdo krahinë, kështu në prag të krijimit të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH në radhët e forcave partizane ishin rreshtuar 10'000 partizanë dhe rreth 20'000 të tjerë ishin rreshtuar në radhët e çetave territoriale vullnetare të territoret e çliruara dhe në njësitet guerile në zonat e pushtuara nga armiku.

Më 4 korrik 1943 në Labinot të Elbasanit Këshilli i Përgjithshëm Nacionalçlirimtar me vendim të KQ të PKSH në mbledhjen e tij vendosi formimin e Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH duke caktuar 12 anëtarë të tij, të cilët ishin: Enver Hoxha, Spiro Moisiu, Myslim Peza, Haxhi Lleshi, Mustafa Xhani, Ramadan Çitaku, Abaz Kupi, Ymer Dishnica, Dali Ndreu, Mustafa Gjinishi, Sejfulla Malëshova, Bedri Spahiu. Shtabi në mbledhjen e tij të parë zgjodhi komisar të Shtabit të Përgjithshëm Enver Hoxhën dhe komandant Spiro Moisiun. Më 10 korrik 1943 Këshilli dhe Shtabi i Përgjithshëm njoftuan popullin për këtë ngjarje që u quajt dita e formimit të ushtrisë së rregullt nacionalçlirimtare. Krijimi i Shtabit të Përgjithshëm ishte një zbatim konkret i idesë të shokut Enver Hoxha dhe një fitore politike ushtarake e PKSH me rëndësi historike për fatet e popullit tonë, ku pas krijimit të Shtabit të Përgjithshëm u krijuan njësitë e rregullta partizane si brigada, divizione dhe korparmata dhe tashmë armiq të jashtëm e të brendshëm kishin të bënin me një forcë të rregullt të armatosur me organizim ushtarak, si gjithë ushtritë e koalicionit antifashist në Luftën e Dytë Botërore.

Shtabi i Përgjithshëm si organ ushtarak strategjik, i ndërgjegjshëm për misionin e tij, iu fut punës për organizimin e UNÇ, realizimin e udhëheqjes strategjike e operative të luftës, planizimin e veprimeve luftarake dhe të operacioneve dhe në këtë kuadër dhe ripunimi i taktikës së luftimit në përshtatje me vetë zhvillimin e luftës e të përmasave të saj.

Në korrik – gusht 1943 ashpërsimi i LANÇ arriti kulmin, operacionet e njëpasnjëshme të armikut dështuan. Kështu më 8 shtator 1943, pas katër vjet e gjysmë lufte Italia fashiste kapitulloi pa kushte, ku kryekomandanti italian që nënshkroi marrëveshjen e kapitullimit u dha urdhër trupave italiane të dorëzoheshin tek gjermanët, ku nga këto forca 15'000 ushtarë, pas thirrjes që u bëri Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH, nuk e zbatuan urdhërin e kryekomandantit, por u dorëzuan tek UNÇSH, nga të cilët 1'500 pranuan të luftojnë me armë në dorë kundër nazistëve gjermanë, duke u radhitur kështu në repartet partizane, ku në gjirin e Brigadës së Parë Sulmuese formuan batalionin „Antonio Gramshi“.

Me pushtimin e vendit nga trupat gjermane u krijua një gjendje e re, ku tipar kryesor i kësaj ishte grumbullimi rreth pushtuesve të rinj i tërë grupeve, rrymave e forcave reaksionare dhe kalimi i tyre në luftë të hapur me armë kundër LANÇ. Në fillim u bashkua Balli Kombëtar dhe më vonë Legaliteti, ku doli hapur Abaz Kupi, anëtar i Shtabit të Përgjithshëm. Si organ ushtarak strategjik Shtabi i Përgjithshëm hap pas hapi do të krijonte kushte për të marrë inisiativën operative-strategjike për kalimin në mësymje të përgjithshme për çlirimin e plotë të vendit. Kështu menjëherë pas krijimit të Shtabit të Përgjithshëm, vetëm në më pak se dy muaj (korrik – gusht) u dhanë mbi 100 goditje bashkëvepruese kundër objektivave të armikut. Shoku Enver Hoxha udhëhoqi partizanët për çlirimin e vendit nga okupatorët e tradhëtarët e vendit me guxim e zgjuarsi të rrallë. Ky është një atribut i strategjeve popullore.

Enver Hoxha u formua si ushtarak në sajë të studimit të përvojës të luftës së popullit tonë në shekuj, eksperiencës së luftrave revolucionare botërore. Këto vlera që fitoi ai janë pasqyruar në LANÇ në hartimin prej tij të planave për zhvillimin e betejave e operacioneve siç kanë qenë:

- Aksionet në shkallë vendi i njësiteve guerile dhe çetave partizane, si aksioni 24 korrikut 1942 për prerjen e linjave telefonike në gjithë vendin.
- Sulmi i forcave partizane për çlirimin e Leskovikut në maj 1943.
- Mësymja e shkallës operative të forcave të UNÇ në krahinën e Përmetit në korrik 1943.
- Mësymja e përgjithshme për çlirimin e vendit nga pushtuesit italiane korrik – shtator 1943.
- Marrja në dorë e situatës dhe thyerja e sulmit gjerman në Arbanë në tetor 1943.
- Plani i masave për përballimin dhe dështimin e mësymjes së përgjithshme të armikut në dimrin e viteve 1943 – 1944.
- Plani për hedhjen e UNÇ në kundërmësymje si dhe drejtimi personalisht i UNÇ në mësymjen pranverore 1944 dhe operacionet e saj strategjike për çlirimin e plotë të Shqipërisë verë – vjeshtë 1944.

„Unë, shkruan gjeneral Spiro Moisiu, kam patur rastin që gjatë gjithë kohës së luftës të kem qenë gjithmonë afër shokut Enver Hoxha dhe më bëntë shumë përshtypje që ai në çdo situatë kritike vendoste me gjakftohtësi dhe gjithnjë vendimet e tij ishin të drejta. Ai ishte shumë i mprehtë, i qartë dhe ecte i sigurtë në vijë e drejtë të fitorës“. Dhe më tej Spiro Moisiu vazhdon: „Gjithë plani i operacioneve të brigadave si gjatë mbrojtjes së Kongresit të Përmetit, ashtu dhe për kalimin e forcave tona në veri të vendit, ka qenë i hartuar nga vetë Enver Hoxha“.

Pushtuesit gjermanë në dimrin e vitit 1943 – 1944 ndërmorën operacionin më qëllim asgjësimit të UNÇSH. Gjatë këtij operacioni Shtabi i Përgjithshëm rrethohet në Martanesh nga forcat gjermane, gjenerali Devis, i drejtohet Enver Hoxhë: „Zoti Hoxha, puna juaj mori fund, jeni të humbur... Tani s'na mbetet gjë tjetër veçse ne të ikim dhe ju të dorëzoheni“. Enver Hoxha i përgjigjet: „Dëgjoni zoti gjeneral! Ne do të vazhdojmë luftën deri në fitorën e plotë. Partizanët shqiptarë nuk kanë humbur dhe nuk do të humbasin asnjë luftë deri në fitore. Italianët i dërmuam dhe gjunjëzuam pa ndihmën e kurrkujt, Gjermanët po ashtu i godasim pa pushim dhe do t'i dërmojmë e gjunjëzojmë edhe ata. Shqiptari t'i dorëzohet armikut? Kjo s'ka ndodhur kurrë“. Shtabi i Përgjithshëm ndonëse i tradhëtuar nga misioni anglez dhe Mehmet Shehu, ish komandant i Brigadës së Parë, që vonoi Brigadën disa ditë që të asgjësohej Shtabi i Përgjithshëm, mundi të dalë nga rrethimi dhe të vazhdojë plotësimin e detyrës për drejtimin e reparteve e njësiteve partizane, ku bëri të mundur dështimin e ofensivës së armikut në 13 operacionet e ndërmarra. Njësitë e UNÇSH kaluan në kundërmësymje dhe në fillim të verës morën inisiativën operative e u hodhën në mësymje strategjike. Kongresi i Përmetit që u mbajt më 24 -28 maj 1944 emëroi shokun Enver Hoxha Komandant i UNÇSH. Komanda gjerman pas dështimit të operacionet të dimrit përgatit operacionin e qershorit 1944. Kështu më 29 maj 1944 ditën që shoku Enver lëshoi urdhërin për kalimin në mësymje të përgjithme, filloj një tjetër mësymje e madhe armike me 4 divizione me efektiv 50'00 forca gjermane e ballisto-zogiste, forca këto aq sa kishte në operacionin e dimrit. Por dhe ky operacion

dështoi. Në këtë kohë ish komandant i operacionit gjerman të qershorit 1944, gjenerali Fen, i shkruan komandantit të Frontit të Evropës juglindore me qendër në Beograd, gjeneralit Nurembergen:“Fronti shqiptar siç po e shikoni dhe vetë zoti gjeneral... përsa i përket meritave të luftës, mund të krahasohet me frontin e ri të perëndimit dhe me frontin e sprovuar të lindjes“. (3.7.1944, Dosje XM, 29, F44)

Madhështia e programit politik e ushtarak, largpamësia e shokut Enver Hoxha u shfaq sidomos në shkrimin e luftës për çlirimin kombëtar me atë për çlirimi shoqëror, prirur nga qëllimi i lartë strategjik të marrjes së pushtetit nga populli dhe jo nga gjakpirësit e tij historikë pas luftës. Kjo masë do t'i sillte popullit shqiptar ringjalljen, do të krijonte premisa të sigurt për kalimin e revolucionit popullor në fazën e tij të luftës për ndërtimin e socializmit dhe të komunizmit. Komanda dhe Shtabit i Përgjithshëm i UNÇSH hodhën poshtë kërkesat dhe presionet e komandës së forcave aleate anglo-amerikane të Mesdheut për ndërprerjen e veprimeve luftarake kundër forcave të tradhëtarit Abaz Kupi dhe vazhdoi luftën për çlirimin e plotë të Shqipërisë të cilën e kurorëzoi më 29 nëntor 1944, ku pas çlirimit me vendim të KQ të PKSH dhe me urdhër të Komandantit të Përgjithshëm Enver Hoxha divizioni i Pestë dhe i Gjashtë Sulmues vazhduan ndjekjen e trupave hitleriane në Jugosllavie më 2 dhjetor 1944 deri janar – shkurt 1945 ku në bashkëveprim me luftëtarët jugosllavë çliruan Malin e Zi, Sanxhakun dhe pjesën jugore të Bosnjës, ku ranë heroikisht 600 partizanë shqiptarë. Që nga 24 tetori 1944 gjithë pjesa jugore e Shqipërisë ishte çliruar. Pushtuesit mbanin ende qytetet Elbasan, Tiranë, Durrës, Kukës dhe Shkodër. Komanda gjermane në pamundësi t'i rezistonin goditjeve të UNÇSH lëshonin njëra pas tjetrës krahina e qytete, pa shpresë për të rezistuar më tej.

Mbeturinat e forcave të reaksionit të grumbulluara rreth krerëve të tyre nën mbrojtjen e ushtrisë gjermane, të vetmen shpresë shpëtimi e kishin vënë të ndojnë zbarkim i mundshëm i trupave anglo-amerikane dhe në përkrahjen nga ana e këtyre trupave, por kjo shpresë u shua, sepse komanda e përgjithme e UNÇSH hodhi poshtë kërkesë e përsëritura të komandës anglo-amerikane të Mesdheut për të sjellë në Shqipëri trupa parashutiste dhe speciale gjoja për të luftuar së bashku kundër gjermanëve. Po kështu kur trupa speciale zbarkimi angleze hynë në Sarandë pas asgjësimit të garnizonit gjerman nga brigadat e UNÇSH komanda e përgjithshme e detyroi shtabin britanik të largonte pa vonesë forcat e veta nga bregdeti shqiptar. Parullat që u hodhën në këtë kohë nga reaksioni se ushtria është barrë ekonomike etj., Enver Hoxha iu dhe përgjigje, që ushtria duhet të forcohet e modernizohet pa ndërprerje, që ta mos përsëritej më 7 prill 1939 për Shqipërinë. Njëkohësisht që më 15 maj 1944 u bënte thirrje kuadrove dhe luftëtarëve, popullit të armatosur se armët që kemi nuk do t'i lëshojmë edhe pas fitores se ato do të kthehen në mburojë të lirisë e pavarësisë së atdheut të çliruar. Enver Hoxha shkëlqeu si komisar e komandant i UNÇSH, si strateg politik e udhëheqës popullor, por edhe si strateg ushtarak, i cili u radhit ndër udhëheqësit e strategët më të mëdhenj të Luftës së Dytë Botërore. Ja çfarë shkruhet në enciklopedinë „Lufta e Dytë Botërore“ (botim francez):“Krahas strategëve të mëdhenj politikë e ushtarakë fitimtarë në këtë luftë, Rusveltit, Stalinit, Çerçillit, Ajzenhauerit, Montgomerit, Zhukovit etj., është radhitur edhe gjeneral armatë Enver Hoxha, komandant i UNÇSH“.

Madhështia e Enver Hoxhës si strateg ushtarak u duk edhe pas çlirimit deri në fund të jetës së tij, ku ai mori të gjitha masat e nevojshme për fuqizimin e mbrojtjes së Atdheut. Kështu organizoi mbrojtjen, mori masa për përgatitjen e kuadrove brenda e jashtë vendit, organizimin e ushtrisë, përgatitjen e popullit ushtarakisht, kompletimin e ushtrisë me teknikë e armatim bashkëkohor, përgatitjen e AUP, fortifikimin e vendit, rivendosjen e KP në ushtri, demokratizimin e jetës së ushtrisë etj. Analizat dhe përgjithësimet marksiste-leniniste në të gjitha shkrimet e tij për problemet ushtarake u bënë fener që ndriçoi rrugën e Partisë, popullit e ushtrisë për të çuar përpara pa rreshtur krahas ndërtimit socialist dhe fuqizimin e mbrojtjes së vendit. Krahas stërvitjes së vogël MMP me orientim të Këshillit të Mbrojtjes dhe personalisht të shokut Enver Hoxha ka bërë stërvitje të mëdha me trupa me pjesëmarrje të madhe në shkallë korpusi dhe deri me pjesëmarrjen e tre korpusve e disa reparteve autonome e forcave vullnetare të rretheve në kushte të përafërta me luftën në të gjitha stinët e vitit, stërvitje këto që i kanë patur zili dhe Traktati i Varshavës e NATO për nga shkalla e organizimit, përgatitjes dhe zhvillimit të tyre, siç kanë qenë stërvitja „Vjosa“ 1962, „Tomorri“ 1968, „Shpiragu“ 1969, „Drini“ 1971, „Peza“ 1972, „Kaptina“ 1973, „Semani“ 1974, „Shebeniku“ 1980 si dhe stërvitje komando-shtabi që është drejtuar nga Këshilli i Mbrojtjes në vitin 1979, ku merrnin pjesë të gjitha organizmat e gjithë vendit që do të merreshin në kohë lufte, organet më të larta shtetërore, kryeministri, ministri i institucione qendrore, organet e pushtetit në bazë, uzina e ndërmarrje ekonomike.

Enver Hoxhsa la një ushtri të organizuar më të gjithë llojet e armëve e shërbimeve me një efektiv 100'000 ushtarë, oficerë e nënoficerë aktivë dhe në rast mobilizimi ushtria popullore kishte një efektiv prej 400'000 forcash, që mobilizoheshin për 6 – 12 orë. Ja çfarë thotë një gjeneral i NATO-s në atë kohë: “Me cilindo ushtri të bllokut komunist, përjashto BRSS, do të mateshim e fitonim me lehtësi, por ne nuk mund të rrezikonim me Shqipërinë e vogël me një komandant ushtarak si Hoxha”.

Me rëndësi të madhe ishte ideja e shokut Enver Hoxha, që për herë të parë u zbatua në praktikë, mësimi i klasikëve të M-L se një ndër hapat e domosdoshëm të revolucionit proletar fitimar është zëvendësimi i ushtrisë klasike të veçuar nga populli, i ushtrisë së mbyllur në kazerma me ushtrinë popullore si pjesë përbërëse e tërë popullit të armatosur, duke e bërë siç thoshte Lenini “çdo qytetar ushtar dhe çdo ushtar qytetar”.

Për këtë për herë të parë në botë u ngritën SHLU për përgatitjen e të gjithë strukturave të popullit ushtar në vitin 1978. Por siç dihet në këtë drejtim ka patur mjaft pengesa, vështirësi, madje edhe sabotime deri në armiqësi. Kështu kundërshtarët puçistë Beqir Balluku, Petrit Dume, Hito Çako, Kadri Hazbiu të dirigjuar nga poliagjenti Mehmet Shehu, duke parë se roli udhëheqës i Partisë në ushtri i pengonte ata në realizimin e qëllimeve të tyre, u orvatën ta godasin atë, bënë përpjekje të vinin komandën mbi Partinë, u përpoqën të përhapin literaturë revizioniste, luftuan të kultivonin në një farë mase edhe një kategori kuadrosh arrogante dhe prepotente, degjenerimin moral, shthurjen e liberalizmin, mashtrimin, bujën e llustrën, u munduan të sabotonin përgatitjen e gatishmërinë luftarake, SHLU, fortifikimin dhe të shkëpusnin ushtrinë nga populli. Pikërisht në këtë situatë tepër të rëndë del përsëri në pah roli vendimtar i shokut Enver Hoxha, i cili arriti të zbulonte fijet e komplotit të

madh, autorët kryesorë të tij. Më 14 tetor 1974 në mbledhjen me kuadrot kryesorë të ushtrisë në fjalën e tij thekson: "Të pastrojmë me fshesë të hekurt veprimtarinë armiqësore të Beqir Ballukut" dhe pa kaluar 2 muaj nga kjo mbledhje, më 17 dhjetor 1974 në mbledhjen e Plenumit të 6 të KQ të PPSH thekson: "Të thellohemi më tej në analizën e komplotit të Beqir Ballukut e Hito Çakos dhe të nxjerrim mësimë për punën e Partisë në ushtri e terren". Siç dihet kjo punë shkoi deri në fund duke nxjerrë puçistët para drejtësisë ku morën dënimin sipas ligjeve duke e pastruar ushtrinë njëherë e mirë nga grupi puçist. Partia dhe shoku Enver ndërtimin e socializmit e mbrojtjen e atdheut i kanë patur dy prioritetet e para dhe të pandara nga njëra-tjetra, ku ecej me parullën: "Të mbajmë në një rën dorë kazmën dhe në tjetrën pushkën". Kështu për të përballuar reaksionin e brendshëm dhe të jashtëm, pra veprimet antishqiptare që synonin rrëzimin e pushtetit popullor, PPSH dhe Enver Hoxha iu desh të bënin sakrificat të mëdha e shpenzime mbi mundësitë tyre, për zhvillimin e vendit e mbrojtjen e tij. Shpifjet që bëjnë sot i gjithë grupimi antikomunist, qeveritë e djathta apo të majta, e të gjithë antishqiptarët se për ushtrinë janë bërë shpenzime të panevojshme, se rreziku i ndonjë sulmi nga jashtë ka qenë imagjinar, se po të donin fuqitë e mëdha të sulmonin na pushtonin për 24 orë etj., u hodhën poshtë teoretikisht dhe praktikisht si të pabaza, sepse synimi imperializmit ka qenë rrëzimi qoftë edhe me forcë i pushtetit popullor e restaurimi i kapitalizmit në vendin tonë ku u punua 50 vjet derisa e arritën të realizonin në vitin 1990. Po japim disa të dhëna të përpjekjeve që janë bërë për rrëzimin e pushtetit popullor:

1. Provokacionet e gushtit 1949 të ushtrisë greke e provokacione të tjera për pretendime territoriale për Vorioepirin, ku dhe sot me Shqipërinë kanë ligjin e luftës, të cilat kanë dështuar me turp.
2. Në vitet e pushtetit popullor nga organet e diktaturës së proletariatit janë kapur e asgjësuar 103 organizata kundërrevolucionare e grupe agjenturore me 1'283 persona, 145 banda me 1'194 diversantë e kriminelë.
3. Qeveria jugosllave ka tentuar të futur në Shqipëri divizionet ushtarake të saj në pretekstin e mbrojtjes së Shqipërisë nga sulmi grek.
4. Tentativa e reaksionit të brendshëm në bashkëpunim me atë të jashtëm për të organizuar trazira në vendin tonë si ajo e Postribës në Shkodër etj.
5. Nga viti 1945 – 1989 janë kapur e dënuar penalisht 8'400 persona për krime kundër shtetit si spiunazh, sabotim, agjitacion e propagandë, tendencë arratise, organizim organizatash kriminale.

Të gjithë të dënuarit penalisht të internuarit dhe personat që nuk ishin anëtarë të Frontit Demokratik (pa triska fronti) bashkë me familjet e tyre zinin 3,2% të popullsisë. Nga të dënuarit penalisht janë dënuar me pushkatim 2 persona.

6. Një dëshmi të fortë të përpjekjes për të rrëzuar pushtetin e popullit në Shqipëri përbëjnë dokumentar e CIA-s dhe deklarata e ish kryeministrit britanik Toni Bler, të publikuara në vitin 2004 edhe në shtypin shqiptar. Ato pohojnë hapur se CIA dhe Inteligjent Servisi, s'kanë lënë gjë pa bërë për të përmbysur pushtetin e Enver Hoxhës, por kanë dështuar.

Ja pse duhej një ushtri e fortë „të nderuar“ pushtetarë borgjezë, ja pse duhej një komandant – strateg politik e ushtarak si Enver Hoxha, ku sa ishte gjallë ai dhe në pozita M-L PPSH, mbrojtja e atdheut dhe fitoreve të revolucionit ishin të garantuara dhe kush guxoi të prekte kufijtë e shenjtë të Shqipërisë gjetën vdekjen.

Të gjithë antishqiptarët që mohojnë Luftën e lavdishme Nacionalçlirimtare, komandantin legjendar të UNÇSH Enver Hoxha, gjakun e 28'000 dëshmorëve të atdheut, do të vijë koha që do të japin llogari para popullit si të gjithë tradhëtarët e deritanishëm.

Ju që hidhni baltë mbi LANÇ, komandantin e saj, Enver Hoxhën, nuk kini dhe as nuk kini forcë të fshini nga kujtesa e popullit patriot shqiptar, lavdinë e LANÇ, gjakun e dëshmorëve të kombit dhe veprën madhore të pavdekshme të udhëheqësit të PKSH, Komandantit të UNÇSH, shokut Enver Hoxha.

Gjon Gjergji

Anëtar i Byrosë Politike të PKSH